



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PEJË - DEGA E GJYKATËS KLINË

Numri i lëndës: 2023:162099

Datë: 18.04.2024

Numri i dokumentit: 05590602

P.nr.124/2023

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE PEJË - DEGA NË KLINË, Departamenti i Përgjithshëm - Divizioni Penal, Gjyqtarja e vetme gjykuese Sabrije Rraci, në çështjen penale kundër të pandehurit, Q (F) K, nga K Rr. „S. R” dhe D (D) H, nga K, Rr. „K i M” të akuzuar me qka në bashkëkryerje kan kryer vepër penale „Lëndim i lehtë trupor “ nga neni 185 par. 1 lidhur me nën. Par 1.4 dhe nenin 31 të KPRRK-së, sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Pejë, PP//II.nr.1063/2023, të datës 24.07.2023, në shqyrtimin fillestar publik të mbajtur me dt.04.04.2024 në praninë e Prokurorit të Shtetit Ramiz Buzhala nga Prokuroria Themelore në Pejë, të pandehurve, Q. K dhe D. H, pas përfundimit të shqyrtimit fillestar të dt.04.04.2024 është bërë shpallja e aktgjykimit, ndërsa me datë 18.04.2024, përpiloi këtë:

A K T G J Y K I M

Kundër të pandehurve:

1.Q. K i lindur me dt....., në K, ku dhe tani banon rruga „S. R,, nga babai F dhe e ëma Sh e vajzërisë D, ka të kryer shkollën e mesme, i pa martuar, me profesion punëtor, i gjendjes së mesme ekonomike, identifikuar me numër personal....., i nacionaliteti shqiptar, Shtetas i Republikës së Kosovës, mbrohet në liri.

2.D. H i lindur me dt....., në P, tani me banim në K, rruga „K i M ,, nga babai D dhe e ëma M e vajzërisë G, ka të kryer shkollën e mesme, i pa martuar, me profesion punëtor, i gjendjes së mesme ekonomike, i identifikuar me numër personal....., i nacionaliteti shqiptar, shtetas i republikës së Kosovës,

JANË FAJTOR

Për shkak se:

Të pandehurit, Q. K dhe D. H:

1.Me datë , rreth orësmin., në fshatin D, rruga qyteti antik „konkretisht afër restorant „L,, me dashje dhe në bashkëveprim përdorin forcën ndaj të dëmtuarit Q. Z, në atë mënyrë që fillimisht derisa i dëmtuari ishte duke shkuar në shtëpi të pandehurit në fjalë i kishin dal para ku i pandehuri Q, e kishte goditur me krah dhe i ishte drejtuar me fjalët „Hajt se shihemi ,, ndërsa ma vonë gjersa i dëmtuari kishte dalë përsëri dhe ishte nisur në drejtim të një furre të bukës dhe me të arritur në vendin e lartcekur ishte takuar përsëri me të pandehurit ku këta të fundit kishin filluar ta godasin me grushta në kokë dhe në trup, ku si pasojë e kësaj të dëmtuarit i shkaktojnë enjtje të indeve të buta të anës së dhjatht të kokës dhe gërvishtje lëkurore të laprës së veshit të djashtë me besueshmëri të shkaktuara nga veprimi mekanik i mjetit të fortë mbretës-gërvishës, (jo i mprehtë i topitur) dhe si të tilla një nga një së bashku bëjnë pjesë në dëmtime të lehta trupore dhe me dëmtim të përkohshëm të shëndetit .

-me çka në bashkëkryerje kanë kryer veprë penale *“lëndim i lehtë trupor ”* nga neni 185 par.1 e lidhur me nënpar.1.4 dhe neni 31 të KPRK-së.

Prandaj gjykata në bazë të neneve 4, 7 , 17, 38, 43, 40 pika 1.3, 69 dhe 70 dhe neni 185 par.1 lidhur me nënpar.1.4 dhe neni 31 të KPRK-së, si dhe nenit 364 të KPPRK-së i:

GJYKON

DËNIM ME GJOBË

Të pandehurit:

1.Q. K, e dënon me dënim me gjobë shuma në vlerë prej 400 (katërqindë) Euro, e cila shumë do të paguhet në afatë prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditësh nga dita e plotfuqishmërisë të këtij aktgjykimi.

II.Nëse i pandehuri nuk dëshiron apo nuk mund ta paguaj gjobën e shqiptuar sipas afatit të dhënë, e njëjta gjobë do të zëvendësohet në dënim me burg, konform nenit 46 par.3 të KPRK-së, ku një ditë burgim do ti llogaritet në 20 uro të gjobës.

2. D. H, e dënon me dënim me gjobë shuma në vlerë prej 400 (katërqindë) Euro, e cila shumë do të paguhet në afatë prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditësh nga dita e plotëfuqishmërisë të këtij aktgjykimi .

II. Nëse i pandehuri nuk dëshiron apo nuk mund ta paguaj gjobën e shqiptuar sipas afatit të dhënë, e njëjta gjobë do të zëvendësohet në dënim me burg, konform nenit 46 par.3 të KPRK-së, ku një ditë burgim do ti llogaritet në 20 uro të gjobës.

III.OBLIGOHEN: Të pandehurit secili veç e veç , që në emër të paushallit gjyqësor të paguajnë në mënyrë solidare nga 10 (dhjet) €, dhe tarifën për kompenzim të viktimave të krimit shumë në vlerë prej 20 (njëzet) €, të gjitha këto në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditësh, pasi aktgjykimi të bëhet i plotëfuqishëm.

UDHËZOHET: Pala e dëmtuar Q (B) Z, nga fsh. D, Lagja e re, qe kërkesën pasurore juridike ta realizoi në kontest civil.

A r s y e t i m

1.Ecuria e procedurës penale

Prokuroria Themelore në Pejë- Departamenti i Përgjithshëm, pranë kësaj Gjykate ka paraqitur aktakuzën, me shenjën PP/II.nr.1063/2023 të datës 24.07.2023, ndaj të pandehurve, Q. K, nga K rr. „S. R” dhe D. H që nga K, Rr. „K. i M” të akuzuar për shkak se në bashkëkryerje kanë kryer veprën penale, Lëndim i lehtë trupor nga neni 185 par.1 lidhur me nënpar.1.4 dhe neni 31 të KPRK-së.

Gjykata mbajti seancën e shqyrtimit fillestar me dt.04.04.2024, gjatë të cilës u dëgjuan Prokurori i Shtetit, Ramiz Buzhala, të akuzuarit Q. K dhe D. H, ndërsa pala e dëmtuar ka munguar.

Pas leximit të aktakuzës nga Prokurori i shtetit, të pandehurit, secili veq e veq jan deklaruar për pranim fajësie:

I pandehuri Q. K ka deklaruar se e pranon fajësinë për veprën penale qe i vihej në barrë, më vie keq për këtë që kam bërë, dhe i njëjti deklaroi se shprehin pendesë për veprën penale të kryer. Ashtu qe nga ajo ditë nuk kemi pasur probleme.

Edhe i pandehuri D. H ka deklaruar se e pranon fajësinë për veprën penale qe i vihej në barrë, më vjen keq për këtë që kam bërë, dhe i njëjti deklaroi se pendohet për veprën penale të kryer.

Gjykata sa i përket pranimin të fajësisë e kërkon mendimin e prokurorit të shtetit lidhur me pranimin e fajësisë nga ana e dy të pandehurve.

Prokurori i Shtetit ka deklaruar se pasi që të pandehurit pranojnë fajësinë dhe ky pranim i fajësisë është bërë me vullnet të lirë dhe pa presion, duke u mbështetur në provat materiale që gjenden në shkresat të lënda. I propozoj gjykatës që të pranojë pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurve për veprën penale që i vihet në barrë, dhe me rastin e marrjes së vendimit, lidhur me dënim, pranimin e fajësisë ta vlerësojë si rrethënë lehtësuese.

Po ashtu të pandehurit kërkojnë nga Gjykata që të ketë lehtësira, me rastin e marrjes së vendimit, duke pasqyruar se në të ardhmen nuk do të përsërisë vepra të tilla, si dhe prej asaj dite nuk kemi pasur më probleme.

2. Vlerësimi i pranimin të fajësisë

Në shqyrtimin fillestar dhe publik, gjykata, pas dëgjimit të palëve, ka marrë aktvendim me të cilin e ka pranuar fajësinë nga dy të akuzuarit e lartcekur, për veprën penale për të cilën është ngarkuar, ngase ka konstatuar se janë plotësuar të gjitha kushtet ligjore nga neni 242 të KPPK-së. Në këtë aspekt gjykata, ka konstatuar se të akuzuarit e kanë kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimin të fajësisë dhe pas njoftimit nga ana e gjykatës lidhur me benifitet dhe pasojat e pranimin të fajësisë, ka vlerësuar se pranimi i fajësisë është bërë vullnetarisht nga të akuzuarit, se pranimi i fajësisë mbështetet në faktet e çështjes që përmban aktakuza dhe se aktakuza nuk përmban asnjë shkelje të qartë ligjore ose gabime faktike.

3. Gjendja faktike e vërtetuar:

Andaj duke u bazuar në këto që u cekën më lartë, gjykata, e ka vërtetuar këtë gjendje faktike: Se të akuzuarit, kanë kryer veprën penale, Lëndim i lehtë trupor nga neni 185 par.1 lidhur me nënpar.1.4 dhe neni 31 të KPRK-së, në kohën, vendin dhe mënyrën e përshkruar si në dispozitivin e këtij aktgjykimi.

4. Vendimi për shpalljen fajtor

Duke u bazuar në këto që u cekën më lart gjykata, ka vendosur që të akuzuarit ti shpall fajtor për kryerjen e veprave penale sipas aktakuzës së cekur më lart, meqenëse është vërtetuar se të njëjti në bashkëkryerje e kanë kryer veprën penale siç edhe vet e kanë pranuar sikurse në kohën, vendin dhe mënyrën e përshkruar sikurse në dispozitiv të aktgjykimit dhe për të njëjtën është përgjegjës. Kjo për faktin se e ka pranuar edhe vet.

5.Rrethanat që janë marrë për bazë me rastin e shqiptimit të dënimit:

Me rastin e shqiptimit të dënimit ndaj të akuzuarës Gjykata, i ka marrë për bazë të gjitha rrethanat që ndikojnë në llojin dhe lartësinë e dënimit, sipas neneve 69 dhe 70 të KPRK-së.

Në këtë aspekt, si rrethanë lehtësuese, mbi bazën e së cilës gjykata e ka shqiptuar dënimin për veprën penale sikurse më lart, është fakti se i akuzuari Q. K ka kryer vepër penale, e ka pranuar fajësinë në shqyrtimin fillestar, dhe pendimin e ti, padënueshmërinë e tyre më parë, si rrethanë tjetër lehtësuese gjykata muar se i pandehuri është i moshës-i ri, është i pa punë. Ndërsa, gjykata sa i përket rrethanave rënduese gjykata gjeti dashjen e kryerjes së veprës penale.

Në këtë aspekt, si rrethanë lehtësuese, mbi bazën e së cilës gjykata e ka shqiptuar dënimin për veprën penale sikurse më lart, është fakti se i akuzuari D. H, ka kryer vepër penale, e ka pranuar fajësinë në shqyrtimin fillestar, dhe pendimin e ti, padënueshmërinë e tyre më parë, si rrethanë tjetër lehtësuese gjykata muar se i se i pandehuri është i moshës-i ri. Ndërsa, gjykata sa i përket rrethanave rënduese gjykata gjeti dashjen e kryerjes së veprës penale.

6.Shqiptimi i dënimit në harmoni me peshën e veprës penale dhe me shkallën e përgjegjësisë penale të akuzuarit dhe qëllimi i dënimit të shqiptuar.

Andaj duke i marrë për bazë rrethanat e përmendura më lartë, është dënim i drejt, në harmoni me peshën e veprës penale dhe shkallën e përgjegjësisë penale të akuzuarit.

Gjykata ka konstatuar se me këto dënime mund të arrihet edhe qëllimi i dënimit, nga neni 38 i KPRK-së, i cili konsiston në parandalimin e të akuzuarit nga kryerja e veprave penale në të ardhmen dhe të bëjë rehabilitimin e tij, por edhe (për mundësinë që të

kthehet në një element kontribues për vete, familjen dhe për rrethin ku jeton) të parandaloj personat tjerë nga kryerja e veprave penale dhe të shpreh gjykimin shoqëror për veprën penale, ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit.

Vendimi për shpenzimet e procedurës dhe paushallit gjyqësor është i bazuar në nenin 449 par. 2 pika 2.6 të KPPK-së, ndërkaq vendimi për pagesën në Fondin për Kompensimin e Viktimave të Krimit është i bazuar në nenin 36 par. 3 nënpar. 3.1 të LKVK-së.

Nga arsyet e cekura më lartë e në bazë të neneve 242 dhe nenit 364 dhe KPPRK-së është vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË PEJË-DEGA KLINË
DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM
P.nr.124/2023 me datë,18.04.2024

Bashkëpunëtoare Profesionale.

Fatmire Elezaj

Gjyqtarja

Sabrije Rraci

KËSHILLA JURIDIKE:

Kundër këtij aktgjykimi palët kanë te drejte te parashtrojnë ankesë në afat prej 30 ditësh, nga dita e marrjes. Ankesa i dërgohet Gjykatës së Apelit në Prishtinë përmes kësaj Gjykate.